



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 65, Datë 12.04.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 116, DATË 24.05.2022,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
“BLUE 1” ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 833/1 prot., datë 08.04.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”, i ndryshuar”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.05.2022, i ndryshuar me vendimin nr. 202, datë 23.06.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25 vjeçar duke filluar nga data e operimit, por jo më vonë se data 01.04.2024.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 833 prot., datë 28.03.2024, i licencuari “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka kërkuar ndryshimin e datës së fillimit të operimit, duke argumentuar se punimet për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik “Blue 1” janë në fazën përfundimtare për të vijuar më pas me energjizimin dhe testimet përkatëse të veprës. Meqenëse punimet për ndërtimin e Nënstacionit 220/110/35/20 kV Hoxharë si dhe të Linjës së Transmetimit 220 kV që lidh Nënstacionin Hoxharë 220/110/35/20 kV me linjën Fier - Babicë janë ende në proces realizimi, energjizimi dhe operimi i Parkut Fotovoltaik “Blue 1” mbetet në funksion të realizimit të investimeve nga OST.

- Për sa më sipër, shoqëria ka kërkuar nga ERE që afati i fillimit të operimit të Parkut Fotovoltaik “Blue 1” të konsiderohet momenti i energjizimit dhe depozitimit të të dhënave të testimit/komisionimit të Parkut Fotovoltaik “Blue 1” pranë ERE-s.
- Në rrethanat kur shoqëria nuk ka filluar ende me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar vlerësojmë të justifikuar kërkesën e saj për të filluar afatin 25-vjeçar të vlefshmërisë së licencës nga dokumentimi në ERE i testimit/komisionimit të Parkut Fotovoltaik “Blue 1”, duke marrë në konsideratë se kjo nuk afekton as përcaktimet e Kontratës nr. 2720 Rep., nr. 2066 Kol., të datës 09.07.2021, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit Përfundimtar. Në nenin 9, pika 2 e kësaj kontrate është parashkuar që Mbajtësi i Miratimit merr përsipër të vërë në punë parkun fotovoltaik brenda 60 muajve nga marrja e të gjitha lejeve për fillimin e punimeve.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashkuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, i ndryshuar, bëhet si vijon:
1.Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga dokumentimi në ERE i testimit/komisionimit të centralit, por jo më vonë se data 09.07.2026.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI